



Rregullore

mbi

Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe
Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë
së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë
(RLAH) me Ballkanin Perëndimor

Dokument për Këshillim Publik

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.1, datë 14.01.2021)

Hyrje

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në vijim të nënshkrimit të “Marrëveshje mbi reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor” (në vijim RRA), bazuar në përcaktimet e ligjit 9918/2008, në Vendimet e Këshillit Drejtues me nr. 21-24, datë 24.6.2019, miratoi dokumentin “Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri – Ballkani Perëndimor”, si dhe detyrimet për tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare të Shqipërisë për zbatimin e marrëveshjes RRA. Në bazë të RRA-s si dhe Vendimeve të AKEP-it, rregullimi i tarifave roaming me vendet e tjera të BP-së (Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), do të kryhet me faza, duke filluar nga data 1 korrik 2019. Në periudhën 1.6.2019 - 30.6.2021 rregullimi i tarifave roaming me pakicë, me vendet e BP kryhet me modelin RLAH+, dhe, duke filluar nga data 1 korrik 2021, përmes modelit RLAH, i cili parashikon heqjen e tarifave roaming me pakicë, kur pajtimtarët e rrjeteve celulare të Shqipërisë vizitojnë vendet e BP.

Rregullimi i tarifave roaming me pakicë në BP, sipas marrëveshjes RRA dhe vendimeve/akteve përkatëse të autoriteteve rregullatorë (NRA) të vendeve të rajonit, është kryer duke vlerësuar modelet RLAH+ dhe RLAH të aplikuara në vendet e BE-së, sipas dokumenteve përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC.

Për sa i përket hapave të mëtejshëm që duhen ndjekur për fillimin e zbatimit të RLAH, nga data 1 korrik 2021, në përputhje dhe me paragrafin e dytë të nenit 6 të RRA, AKEP-i ka përgatitur këtë draft-rregullore “Mbi zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor”, e cila është bazuar në Rregulloren Implementuese të Komisionit (BE) 2016/2286 të datës 15 dhjetor 2016, “Mbi përcaktimin e rregullave të hollësishme për zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë dhe mbi metodologjinë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave shtesë me pakicë të roaming-ut dhe mbi kërkesën që duhet të paraqitet nga një ofrues i roaming për qëllime të këtij vlerësimi”¹ duke i përshtatur parashikimet e këtij dokumenti të BE-së në kontekstin e RRA-së dhe vendeve të BP-së.

Në vijim të udhëzimeve të nxjerra nga AKEP në vitin 2019 për zbatimin e RLAH+ dhe, me qëllim dhënien e sqarimeve të mëtejshme për zbatimin e detyrimeve për Politikën e Përdorimit të Drejtë sipas kësaj rregulloreje që do të miratohet pas këshillimit publik, AKEP do të plotësojë kuadrin rregullator me nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, të cilat do të bazohen në Udhëzimet e BEREC në BoR (17) 56.²

AKEP-i, bazuar në marrëveshjen e roaming-ut Shqipëri - Kosovë, nënshkruar nga ministritë përkatëse në Pejë, më datë 26.11.2018, me vendimet nr. 16-18, datë 11.5.2019, ka miratuar rregullat përkatëse për tre operatorët celularë të Shqipërisë për aplikimin e modeleve RLAH+ dhe

¹ Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 of 15 December 2016 laying down detailed rules on the application of fair use policy and on the methodology for assessing the sustainability of the abolition of retail roaming surcharges and on the application to be submitted by a roaming provider for the purposes of that assessment

² BoR (17) 56: BEREC Guidelines on Regulation (EU) No 531/2012, as amended by Regulation (EU) 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail Roaming Guidelines).

RLAH me Kosovën, të cilat janë të njëjta me detyrimet e vendosura nëpërmjet vendimeve nr. 22-24, datë 24.6.2019, me ndryshim të vetëm nivelin e tarifës maksimale për roaming për të dhënat (aksesi në internet) në periudhën 15.6.2019 - 30.6.2021. Ndërsa, prej datës 1.7.2021, të gjitha detyrimet e përcaktuara në vendimet e cituara janë të njëjta, si për roaming-un me Kosovën, ashtu edhe për roaming-un me vendet e tjera të BP. Për sa më sipër, AKEP-i si bazë ligjore për këtë rregullore ka përcaktuar marrëveshjen RRA dhe vendimet e AKEP-it me nr. 21-24, datë 24.6.2019, dhe, sipas rasis, në dokument janë përfshirë edhe referenca me vendimet nr. 16-18/2019.

Përmbajtja e dokumentit:

Kapitulli I, përmban dispozita të përgjithshme, përfshirë bazën ligjore, objektin dhe fushën e veprimit të Rregullores, si dhe përkufizime.

Kapitulli II, Politika e përdorimit të Drejtë, përmban detyrimet për operatorët celularë në rast të aplikimit të ndonjë Politike të Drejtë Përdorimi (Fair Use Policy- FUP) për shërbimet e rregulluara roaming me pakicë gjatë aplikimit të modelit RLAH, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose anormal të shërbimeve të roaming-ut me pakicë nga pajtimtarët gjatë roaming-ut në vendet e BP, për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik në këto vende.

Kapitulli III, Kërkesa dhe metodologjia për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave me pakicë roaming, përmban përcaktimet për operatorët celularë që mund të kërkojnë autorizim nga AKEP-i për të aplikuar tarifa shtesë roaming, në mënyrë që të sigurojnë qëndrueshmërinë e modelit të tarifimit të shërbimeve brenda vendit gjatë aplikimit të RLAH.

Kapitulli IV, Përcaktime Finale, përmban parashikime mbi monitorimin e zbatimit të detyrimeve të operatorëve sipas kapitujve II dhe III, si dhe hyrjen në fuqi dhe fillimin e efekteve të kësaj rregulloreje.

Anekset I dhe II, përmbajnë detaje mbi llogaritjen e treguesve të ndryshëm të referuar në Kapitullin III.

Në mbështetje të neneve 7, 8, 51, 55 e në vijim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”,³ vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21-24, datë 26.6.2019.

³ “Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”, e nënshkruar nga ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia) në Beograd, më 4 prill 2019.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

1. Kjo rregullore përcakton rregulla të detajuara për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të politikave të përdorimit të drejtë (Fair Use Policy – FUP) që operatorët celularë të RSH-së mund të aplikojnë për konsumin e shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, ofruar pajtimtarëve me tarifën e aplikueshme me pakicë brenda vendit sipas modelit RLAH, në përputhje me nenin 4/6 të vendimeve të AKEP nr. 22-24, datë 24.6.2019, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose jonormal të shërbimeve të roaming-ut me pakicë nga pajtimtarët gjatë roaming-ut në vendet e BP⁴ për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik në këto vende.
Çdo FUP i aplikuar nga operatorët celularë të RSH-së duhet t’u mundësojë pajtimtarëve të tyre të konsumojnë volumet e shërbimeve të rregulluara roaming në BP me modelin RLAH, sipas tarifave përkatëse të aplikueshme brenda vendit dhe në përputhje me planet përkatëse tarifore të pajtimtarëve.
2. Kjo rregullore përcakton gjithashtu rregulla të hollësishme për:
 - (a) kërkesat që operatorët celularë mund të depozitojnë në AKEP për autorizim për të zbatuar një tarifë shtesë roaming (surcharge) në përputhje me parashikimet e pikës 4/7 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së modeleve të tyre të tarifimit brenda vendit.
 - (b) metodologjinë për t’u zbatuar nga AKEP në vlerësimin nëse operatori celular ka provuar se nuk është në gjendje të mbulojë kostot e tij për të ofruar shërbime të rregulluara të roaming, pasi kjo do të dëmtonte qëndrueshmërinë e modelit të tij të tarifimit të shërbimeve brenda vendit.
3. Çfarëdo tarife shtesë e aplikuar nga operatorët celularë të RSH-së për shërbimet e rregulluara të Roaming-ut në modelin RLAH sipas pikës 2/a më sipër dhe për shërbimet që tejkalojnë sasi të limit të përcaktuara nga FUP, nuk duhet të tejkalojë tarifatat maksimale

⁴ Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

me shumicë të specifikuara në paragrafin 3.1, tabela 1, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, sipas periudhës përkatëse.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në vendimet nr. 22-24/2019 të AKEP-it.
2. Gjithashtu zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - (a) "lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë" nënkupton praninë e pajtimtarit në territorin e Shqipërisë, që rrjedh ndër të tjera:
 - nga një marrëdhënie punësimi me kohë të plotë dhe të qëndrueshme (afatgjatë), përfshirë atë të punonjësve ndërkufitarë;⁵
 - marrëdhëniet kontraktuale afatgjata, që sjellin një shkallë të ngjashme të pranisë fizike të një personi të vetëpunësuar;
 - pjesëmarrja në kurse periodike studimi me kohë të plotë; ose
 - situata të tjera, të tilla si ato të punëtorëve sezonalë ose ato të personave në pension, sa herë që përfshijnë një nivel të ngjashëm të pranisë territoriale.
 - (b) "shërbime celulare me pakicë" do të thotë shërbime publike të komunikimeve të rrjeteve të lëvizshme të ofruara për përdoruesit fundorë, duke përfshirë shërbimet e thirrjeve zanore, SMS-të dhe të të dhënave.
 - (c) "paketë e hapur të dhënash" (*open data bundle*) nënkupton një plan tarifor për ofrimin e një ose më shumë shërbimeve celulare me pakicë, i cili nuk kufizon vëllimin/sasinë e shërbimeve celulare me pakicë të të dhënave, të përfshira në paketë kundrejt pagesës së një tarife periodike fikse, ose për të cilën çmimi për njësi brenda vendit i shërbimeve celulare me pakicë të të dhënave, që rezulton nga pjesëtimi i çmimit të përgjithshëm të shitjes me pakicë brenda vendit, pa TVSH, për shërbimet celulare që i përkojnë të gjithë periudhës së faturimit, me vëllimin/sasinë e përgjithshme të shërbimeve me pakicë të

⁵ Një punonjës që është i punësuar në një vend të BP-së, kufitar me Shqipërinë, por që kthehet çdo ditë ose të paktën një herë në javë në Shqipëri. (*In the EU context, a worker who is employed in the frontier zone of an EU Member State but who returns each day or at least once a week to the frontier zone of a neighbouring country in which they reside and of which they are nationals.*)

- të dhënave celulare të disponueshme brenda vendit (në Shqipëri), është më i ulët se tarifa maksimale e rregulluar me shumicë të roaming referuar në pikën 3 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, sipas periudhave përkatëse;
- (d) "plan tarifor me parapagim" nënkupton një plan tarifor sipas të cilit shërbimet me pakicë celulare ofrohen nëpërmjet zbritjes nga kreditet e parapaguara nga pajtimtari të vlerave monetare përkatëse për çdo njësi shërbimi të konsumuar, d.m.th., tarifim me parapagim për njësi shërbimi, dhe, nga i cili, pajtimtari mund të tërhiqet pa penaltete pas përdorimit të plotë të tyre ose përfundimit të afatit të përdorimit të kredive;
 - (e) "vend i vizituar i BP" nënkupton një vend të BP-së të ndryshëm nga Shqipëria d.m.th., Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia;
 - (f) "marzhi i shërbimeve celulare" do të thotë fitimi, përpara interesave, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit, nga shitja e shërbimeve celulare, përveç shërbimeve me pakicë roaming të ofruara në vendet e BP-së, duke përjashtuar kështu kostot dhe të ardhurat nga shërbimet e shitjes me pakicë gjatë roaming-ut;
 - (g) "grup" nënkupton ndërmarrjen-mëmë dhe të gjitha ndërmarrjet filiale të saj që i nënshtrohen kontrollit të saj në kuptim të ligjit nr. 9121/2003⁶.
 - (h) "klient roaming" do të thotë një klient i një operatori celular në RSH si ofruesi roaming i shërbimeve të rregulluara të roaming-ut, me anë të një rrjeti të lëvizshëm të komunikimeve publike (rrjet celular), kontrata ose marrëveshja e të cilit, me atë ofrues të roaming, lejon roaming në të gjitha vendet e BP-së.

⁶ Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

KAPITULLI II

POLITIKA E PËRDORIMIT TË DREJTË

Neni 3

Parimi bazë

1. Një operator celular do të ofrojë shërbime të rregulluara roaming me pakicë sipas çmimeve përkatëse brenda vendit për pajtimtarët e tij, të cilët zakonisht janë rezidentë (me banim) ose kanë lidhje të qëndrueshme, duke sjellë një prani të shpeshtë dhe të konsiderueshme në Shqipëri, ndërsa ata udhëtojnë periodikisht në vendet e BP.
2. Çdo politikë e drejtë përdorimi e aplikuar nga një operator celular për të parandaluar përdorimin abuziv ose jonormal (me anomali) të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë do t'i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje dhe do të garantojë që të gjithë këta klientë të roaming-ut të kenë akses në shërbimet e rregulluara roaming me pakicë me çmimin/çmimet e aplikuara brenda vendit (në Shqipëri) gjatë udhëtimeve të tilla periodike në vendet e BP-së me kushte të njëjta sikundër këto shërbime të konsumohen në Shqipëri.

Neni 4

Përdorim i drejtë

1. Për qëllime të çdo politike të përdorimit të drejtë, ofruesi i roaming ka të drejtë të kërkojë nga pajtimtarët (klientët) e tij roaming të japin prova të qëndrimit/banimit normal në Shqipëri ose të lidhjeve të tjera të qëndrueshme me Shqipërinë, që sjell një prani të shpeshtë dhe të qenësishme në territorin e Shqipërisë.
2. Pa cenuar ndonjë kufi të zbatueshëm të sasisë së lejuar brenda vendit, në rastin e një pakete të hapur të të dhënave, klienti roaming, kur udhëton periodikisht në BP do të jetë në gjendje të konsumojë një sasi të shërbimeve roaming me pakicë të të dhënave, me çmimin me pakicë të aplikuar në Shqipëri, ekuivalent me të paktën dyfishin e sasisë/vëllimit që rezulton nga pjesëtimi i çmimit të përgjithshëm me pakicë (pa TVSH) brenda vendit të asaj pakete të hapur të të dhënave, që korrespondon me të gjithë periudhën e faturimit, me tarifën maksimale me shumicë të rregulluar roaming, të referuar në pikën 3 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, sipas periudhave përkatëse.

Në rast të shitjes së paketave të integruara të shërbimeve celulare me pakicë me shërbime ose terminale të tjerë, çmimi i përgjithshëm i shitjes me pakicë të paketës së të dhënave brenda vendit, për qëllimet e nenit 2(2)/c dhe të këtij paragrafi, do të përcaktohet, duke marrë parasysh çmimin e aplikuar (pa TVSH) për shitjen më vete të elementit të shërbimeve me pakicë të paketës, nëse është e disponueshme, ose çmimin për shitjen më vete (stand alone) të shërbimeve të tilla me të njëjtat karakteristika.

3. Në rastin e planeve tarifore me parapagim, si një alternativë e kërkesës së politikës së përdorimit të drejtë në paragrafin 1, operatori celular ka të drejtë të kufizojë konsumin e shërbimeve me pakicë të të dhënave brenda BP-së me çmimin e shitjes me pakicë në Shqipëri në vëllime/sasi ekuivalente me të paktën vëllimin/sasinë që rezulton nga pjesëtimi i vlerës së përgjithshme (pa TVSH) të kreditit të mbetur në dispozicion (dhe të paguar tashmë nga klienti për operatorin) në momentin e fillimit të përdorimit të roaming, me tarifën maksimale me shumicë të rregulluar roaming, të referuar në pikën 3 të vendimeve të AKEP-it me nr. 22-24/2019, sipas periudhave përkatëse.
4. Në kontekstin e përpunimit të të dhënave të trafikut sipas nenit 124 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, me qëllim parandalimin e përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve të rregulluara roaming, të ofruara me çmimin e aplikueshëm të shitjes me pakicë brenda vendit, operatori celular mund të zbatojë mekanizma të kontrollit të drejtë, të arsyeshëm dhe proporcionalë, bazuar në tregues objektivë, që lidhen me riskun e përdorimit abuziv ose anormal të roaming-ut, që dalin jashtë kontekstit të udhëtimeve periodike në BP.

Treguesit objektivë mund të përfshijnë masa për të përcaktuar nëse konsumi i klientit për shërbimet brenda vendit mbizotëron ndaj konsumit në roaming, ose, nëse prezenca/prania e klientit brenda vendit mbizotëron ndaj asaj në vendet e tjera të BP.

Për të siguruar që klientët në roaming, të angazhuar në udhëtime periodike, nuk i nënshtrohen alarmeve/njoftimeve paralajmëruese të panevojshme ose të tepërta në përputhje me nenin 5 (4) të kësaj Rregulloreje, operatorët celularë që zbatojnë masa të tilla për të përcaktuar një rrezik përdorimi abuziv ose anormal të shërbimeve roaming do të vëzhgojnë të tillë tregues të pranisë dhe konsumit në mënyrë kumulative dhe për një periudhë kohore prej së paku 4 mujore.

Operatori celular në kontratat me pajtimtarët/klientët që aktivizojnë roaming do të specifikojë se për cilin shërbim ose shërbime celulare me pakicë është i lidhur treguesi i konsumit, si dhe kohëzgjatjen e periudhës minimale të monitorimit të konsumit/sjelljes së tij.

Si mbizotërimi i konsumit të klientit brenda vendit ndaj konsumit në roaming, edhe prania e klientit më e madhe në Shqipëri se në roaming, gjatë periudhës së përcaktuar të monitorimit do të konsiderohet si një provë e përdorimit jo-abuziv dhe jo-anormal të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë.

Për qëllimin e nënparagrafit të dytë, të tretë dhe të pestë të këtij paragrafi, çdo ditë, kur një klient roaming është futur (loguar) në rrjetin e operatorit në Shqipëri, do të llogaritet si një ditë e pranisë brenda vendit të këtij klienti.

Tregues të tjerë objektivë të një rreziku të përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, të ofruara me çmimin e aplikueshëm të shitjes me pakicë brenda vendit, mund të përfshijnë vetëm:

- (a) pasivitetin (periudhë inaktive) e gjatë të një karte të caktuar SIM, që shoqërohet me përdorim të saj kryesisht, apo edhe ekskluzivisht, për roaming;
- (b) pajtimin dhe përdorimin sekuencial të shumë kartave SIM (multiple SIM) nga i njëjti klient gjatë roaming-ut.

5. Kur operatori celular përcakton, me prova objektive dhe të vërtetuara, se një numër i kartave SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar për persona që nuk banojnë në mënyrë efektive ose kanë lidhje të qëndrueshme, që sjellin prani të shpeshtë dhe të konsiderueshme në Shqipëri për të mundësuar konsumin e shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë, të ofruara me çmimin e aplikueshëm me pakicë në Shqipëri për qëllime të ndryshme nga ato të udhëtimit periodik, operatori celular mund të marrë masa të menjëhershme proporcionale, në mënyrë që të sigurojë pajtueshmërinë (respektimin) me të gjitha kushtet e kontratës përkatëse me klientin roaming.

6. Në rastet kur MNO vepron në përputhje me këtë seksion, ka detyrime, njëkohësisht, të veprojë në përputhje me përcaktimet e Kreut XV të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
7. Përcaktimet e kësaj rregulloreje nuk janë të zbatueshme për politikat e përdorimit të drejtë që mund të jenë të përcaktuara në termat kontraktuale të tarifave alternative të roaming, të ofruara në përputhje me pikën 4/10 të vendimeve me nr. 22-24/2019 të AKEP.

Neni 5

Transparenca dhe mbikëqyrja e politikave të përdorimit të drejtë

1. Kur një operator celular aplikon një politikë përdorimi të drejtë në ofrimin e roaming, ai përfshin në kontratat me pajtimtarët/klientët roaming të gjitha termat dhe kushtet e lidhura me atë politikë, mes tyre edhe çdo mekanizëm kontrolli të përdorur në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje. Si pjesë e politikës së përdorimit të drejtë, ofruesi i roaming-ut ka detyrim të vendosë procedura transparente, të thjeshta dhe efikase, për të adresuar ankesat e pajtimtarëve në lidhje me zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë. Kjo nuk cenon të drejtat e pajtimtarit/klientit në roaming, për të përfituar nga procedurat transparente, të thjeshta, të drejta dhe të menjëhershme jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008 dhe aktet rregullatore të AKEP-it. Një mekanizëm i tillë i ankesave dhe procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do t'i mundësojnë klientit/pajtimtarit të roaming të japë prova që nuk është duke i përdorur shërbimet e rregulluara të roaming me pakicë për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik, për shkak të marrjes së një alarmi/njoftimi paralajmërues, në përputhje me këtë nen.
2. Operatorët celularë kanë detyrim të njoftojnë AKEP për çdo politikë të përdorimit të drejtë, të hartuar në përputhje me këtë rregullore, të paktën 15 ditë përpara publikimit të tyre.
3. Në rastet kur ka prova objektive dhe të vërtetuara, mbështetur në treguesit objektivë të përmendur në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, që tregojnë për një rrezik të përdorimit abuziv ose anormal nga një pajtimtar i caktuar i shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë në vendet e BP-së, sipas çmimeve brenda vendit, operatori celular i RSH duhet të paralajmërojë pajtimtarin për modelin e sjelljes së zbuluar, që tregon një rrezik të tillë

përpara se të aplikojë ndonjë tarifë shtesë në përputhje me vendimet nr. 22-24/2019 të AKEP-it, dhe pikën 3, të nenit 1, të kësaj Rregulloreje.

Në rastet kur një rrezik i tillë rrjedh nga mospërmbushja e të dy kritereve të mbizotërimit të konsumit dhe pranisë brenda vendit ndaj atyre në roaming, gjatë periudhës së përcaktuar të monitorimit, referuar në pikën pesë të nenit 4 të kësaj Rregulloreje, për qëllime të zgjidhjes së ndonjë ankese të mëvonshme, siç parashikohet në paragrafin (1) ose për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator, në përputhje me ligjin nr. 9918/2008 dhe rregulloret e AKEP-it, për shkak të aplikimit të tarifave shtesë roaming, duhet të merren në konsideratë dhe indikacione shtesë të rrezikut që vijnë nga prania e përgjithshme e pajtimtarit/klientit roaming, apo përdorimi prej tij i shërbimeve kryesisht jashtë vendit (jo në Shqipëri).

Ky paragraf do të zbatohet, pavarësisht nga sigurimi prej klientit/pajtimtarit roaming të provave dokumentare të qëndrimit/banimit ose lidhjeve të tjera të qëndrueshme që sjell praninë e shpeshtë dhe të konsiderueshme në Shqipëri, në përputhje me nenin 4.

4. Kur operatori celular i dërgon pajtimtarit roaming njoftimin e paralajmërimit (alert) të rrezikut në përputhje me paragrafin 3, ai do të informojë pajtimtarin që, në mungesë të një ndryshimi në modelin e përdorimit brenda një periudhe, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 2 javë, dhe që dëshmon konsumin apo praninë aktuale brenda vendit, mund të zbatohet një tarifë shtesë, sipas përcaktimeve të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, për çdo përdorim të mëtejshëm të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë me kartën SIM në fjalë, pas datës së një njoftimi të tillë.
5. Operatori celular pushon së aplikuari tarifën shtesë sapo përdorimi i klientit të mos përbëjë më rrezik të përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, mbështetur në treguesit objektivë të përmendur në nenin 4 (4).
6. Kur një operator celular përcakton se kartat SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar ndaj personave që as nuk banojnë normalisht dhe as nuk kanë lidhje të qëndrueshme e që sjellin prani të shpeshtë dhe të konsiderueshme në Shqipëri, për të mundësuar konsumin e shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë për qëllime të ndryshme nga ato të udhëtimit periodik jashtë Shqipërisë në përputhje me nenin 4 (3), operatori duhet t'ia bëjë të njohura AKEP-it provat që karakterizojnë abuzimin sistematik në fjalë dhe masën e marrë, për të

siguruar përputhshmërinë me të gjitha kushtet e kontratës përkatëse. Ky njoftim dërgohet në AKEP jo më vonë se koha e ndërmarrjes së masave të tilla

KAPITULLI III
APLIKIMI DHE METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E QËNDRUESHMËRISË SË
HEQJES SË TARIFAVE ME PAKICË ROAMING

Neni 6

**Të dhëna që mbështesin aplikimin e një operatori celular për autorizim për
zbatimin e një tarife shtesë roaming**

1. Aplikimet për autorizim për të zbatuar një tarifë shtesë roaming të depozituara nga një operator celular, si ofruet roaming në përputhje me pikën 4/7 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e modelit të tij të tarifimit ('aplikimi') do të vlerësohen në bazë të të dhënave për vëllimet e përgjithshme të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë të ofruara nga aplikanti, të projektuar për një periudhë prej 12 muajsh, dhe që fillon jo më herët se 1 korrik 2021. Për aplikimin e parë, këto parashikime të vëllimit do të vlerësohen duke përdorur një prej mundësive të mëposhtme ose një ndërthurje e tyre:
 - a) vëllimet aktuale të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë të ofruara nga aplikuesi me çmimin e zbatueshëm të rregulluar të roaming-ut para datës 1 korrik 2021;
 - b) vëllimet e parashikuara të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë pas datës 1 korrik 2021, ku vëllimet e parashikuara të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë, gjatë periudhës në fjalë, vlerësohen bazuar në konsumin aktual të brendshëm të shitjeve me pakicë të shërbimeve celulare dhe kohën e kaluar jashtë Shqipërisë, në BP, nga klientët roaming të aplikantit;
 - c) vëllimet e parashikuara të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë pas datës 1 korrik 2021, ku vëllimet e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë vlerësohen bazuar në ndryshimin proporcional në vëllimet e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut të ndodhura në planet tarifore të aplikuesit, që përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të bazës së klientëve, për të cilët çmimet e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut janë vendosur në nivelin e tarifave brenda

vendit nga aplikuesi për një periudhë prej të paktën 30 ditësh, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Aneksin I të kësaj Rregulloreje.

Në rast të përditësimeve të aplikimit, vëllimet e përgjithshme të parashikuara të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut do të përditësohen në bazë të modelit aktual të konsumit mesatar të shërbimeve celulare brenda vendit, të shumëzuar me numrin e vëzhguar të klientëve roaming dhe kohën që ata kanë kaluar në vendet e vizituara të BP-së në 12 muajt e mëparshëm.

2. Çdo e dhënë në lidhje me kostot dhe të ardhurat e aplikantit do të mbështetet në llogaritë financiare, të cilat do të vihen në dispozicion të AKEP-it dhe mund të përshtaten sipas vlerësimeve të vëllimeve të shërbimeve, në përputhje me paragrafin 1. Në rastet e parashikimit të kostove, shmangiet nga shifrat që rezultojnë nga llogaritë financiare të periudhës së mëparshme, do të merren në konsideratë vetëm nëse mbështeten me prova të angazhimeve financiare për periudhën e parashikuar.
3. Aplikanti do të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme të përdorura për të përcaktuar marzhin e shërbimeve celulare dhe kostot, si dhe të ardhurat e përgjithshme aktuale e të parashikuara të ofrimit të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut gjatë periudhës përkatëse.

Neni 7

Përcaktimi i kostove specifike të roaming-ut për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut

1. Me qëllim vërtetimin se aplikanti nuk është në gjendje të rikuperojë kostot e tij, e cila sjell si pasojë dëmtimin e aftësisë së qëndrueshmërisë së tarifimit të shërbimeve brenda vendit të aplikuesit, në konsideratë do të merren vetëm kostot specifike të mëposhtme të roaming-ut, nëse ato janë të mbështetura me prova në kërkesën/aplikimin për autorizim për të aplikuar një tarifë shtesë në roaming:
 - a) kostot për blerjen e aksesit me shumicë në roaming;
 - b) kostot specifike të shitjes me pakicë të roaming-ut.

2. Në lidhje me kostot e shkaktuara nga blerja e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me shumicë, do të merret në konsideratë vetëm shuma me të cilën pagesat e përgjithshme të aplikuesit për homologët që ofrojnë shërbime të tilla në BP, pritet të tejkalojnë shumat e përgjithshme të detyruara nga këta operatorë homologë për aplikuesin për ofrimin e të njëjtave shërbime për ofruesit e tjerë të roaming-ut në BP. Përsa i përket shumave që i detyrohen ofruesit të roaming-ut për ofrimin e shërbimeve të rregulluara, ofruesi i roaming-ut do të supozojë vëllime të parashikuara të këtyre shërbimeve me shumicë, që janë në përputhje me supozimin që përdoret për vëllimet e tij të parashikuara sipas nenit 6 (1).
3. Në lidhje me kostot e shitjes me pakicë specifike për roaming, do të merren parasysh vetëm kostot e mëposhtme, nëse ato janë të vërtetuara në kërkesë:
 - a) kostot e operimit dhe menaxhimit të aktiviteteve të roaming-ut, përfshirë të gjitha sistemet e inteligjencës së biznesit dhe softuerin e dedikuar për funksionimin dhe menaxhimin e roaming-ut;
 - b) kostot e data-clearing dhe pagesave, duke përfshirë shpenzimet për data-clearing dhe likuidimin financiar (*financial clearing*);
 - c) kostot e negocimit të kontratave dhe marrëveshjeve, përfshirë tarifat e jashtme dhe përdorimin e burimeve të brendshme;
 - d) shpenzimet e kryera për të qenë në përputhje me kërkesat për sigurimin e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut, të përcaktuara në pikën 5 dhe 6 të vendimeve nr. 16-18/2019 dhe nr. 22-24/2019 të AKEP-it, duke marrë parasysh politikën e zbatueshme të përdorimit të drejtë, të miratuar nga ofruesi i roaming-ut.
4. Kostot e referuara në pikat (a), (b) dhe (c) të paragrafit 3 do të merren parasysh vetëm në përpjesëtim me raportin e vëllimit të përgjithshëm të trafikut të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut të aplikuesit ndaj trafikut të përgjithshëm me pakicë outbound, si dhe trafikut me shumicë inbound të shërbimeve të tij roaming, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Aneksin II, pikat (1) dhe (2), dhe në përpjesëtim me raportin e shumës së përgjithshme të trafikut të shërbimeve të tij të roaming-ut me pakicë brenda BP-së, me trafikun e përgjithshëm të tij të shërbimeve të roaming-ut me pakicë brenda dhe jashtë BP-së, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Aneksin II, pikat (1) dhe (3).
5. Kostot e referuara në pikën (d) të paragrafit 3 do të merren parasysh vetëm në përpjesëtim me raportin e vëllimit të përgjithshëm të trafikut të shërbimeve të roaming-ut me pakicë të

aplikantit brenda BP-së, me trafikun e përgjithshëm të shërbimeve të tij të roaming-ut me pakicë brenda dhe jashtë BP-së, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Aneksin II, pikat (1) dhe (3).

Neni 8

Alokimi i kostove të bashkuara dhe të përbashkëta (*joint and common*) me pakicë për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roaming

1. Përveç kostove të përcaktuara në përputhje me nenin 7, në kërkesën për autorizim për të aplikuar një tarifë shtesë në roaming mund të përfshihet edhe një pjesë e kostove të bashkuara dhe të përbashkëta të shkaktuara nga ofrimi i shërbimeve celulare me pakicë në përgjithësi. Vetëm kostot e mëposhtme do të merren parasys, nëse vërtetohen në kërkesë:
 - a) kostot e faturimit dhe mbledhjes së pagesave, duke përfshirë të gjitha kostot që lidhen me përpunimin, llogaritjen, prodhimin dhe njoftimin e faturës aktuale të klientit;
 - b) kostot e shitjes dhe shpërndarjes, përfshirë kostot e operimit të dyqaneve dhe kanaleve të tjera të shpërndarjes për shitjen e shërbimeve celulare me pakicë;
 - c) kostot e kujdesit ndaj klientit, përfshirë koston e operimit të të gjitha shërbimeve të kujdesit ndaj klientit në dispozicion të përdoruesit fundor;
 - d) kostot e menaxhimit të borxheve të këqija, përfshirë kostot e shkaktuara nga fshirja e borxheve të pashlyera të klientëve dhe për të mbledhur borxhet e këqija;
 - e) kostot e marketingut, përfshirë të gjitha shpenzimet për reklamimin e shërbimeve celulare.
2. Kostot e përmendura në paragrafin 1, nëse vërtetohen në aplikim, do të merren parasys vetëm në përpjesëtim me raportin e trafikut të përgjithshëm të shërbimeve të roaming-ut me pakicë të aplikantit brenda BP ndaj trafikut të përgjithshëm me pakicë të të gjitha shërbimeve celulare me pakicë, e marrë si një mesatare e ponderuar e këtij raporti për shërbimin celular, me pesha që pasqyrojnë çmimet përkatëse mesatare të shitjes me shumicë, të paguara nga aplikuesi në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Aneksin II, pikat (1) dhe (4).

Neni 9

Përcaktimi i të ardhurave nga sigurimi i shërbimeve të rregulluara të roaming

1. Për qëllime të vërtetimit se aplikuesi nuk është në gjendje të rikuperojë kostot e tij, të cilat kanë si efekt dëmtimin e aftësisë së qëndrueshmërisë së tarifimit të shërbimeve brenda vendit të aplikuesit, do të merren parasysh vetëm të ardhurat e mëposhtme dhe të përfshira në kërkesën për autorizim për të aplikuar një shtesë në roaming:
 - a) të ardhurat që rrjedhin drejtpërdrejt nga trafiku i shërbimeve celulare me pakicë të origjinuara në vendet e vizituara të BP-së;
 - b) një pjesë e të ardhurave të përgjithshme nga shitja e shërbimeve celulare me pakicë, mbështetur në tarifatat fikse periodike.
2. Të ardhurat e përmendura në pikën (a) të paragrafit 1 do të përfshijnë:
 - a) të ardhura nga tarifatat me pakicë të aplikuara në përputhje me pikën 4/6 të vendimeve nr. 16-18/2019 dhe nr. 22-24/2019 të AKEP-it, dhe pikën 3 të nenit 1 të kësaj Rregulloreje, për trafikun që tejkalon çdo politikë të përdorimit të drejtë të zbatuar nga ofruesi i roaming-ut;
 - b) të ardhurat nga shërbimet e rregulluara të roaming-ut me tarifa alternative, në përputhje me pikën 4/10 të vendimeve nr. 16-18/2019 dhe nr. 22-24/2019 të AKEP-it;
 - c) të ardhurat nga shërbimet me pakicë, të marra për shkak të roaming-ut në një vend të vizituar të BP-së dhe të tarifuara me tarifë brenda vendit në bazë konsumi për njësi ose me tarifa fikse periodike;
3. Për qëllimet e përcaktimit të të ardhurave të përmendura në pikën (b) të paragrafit 1, në rast të shitjes me paketa (bundles) të shërbimeve celulare me pakicë me shërbime të tjera ose pajisje fundore, do të merren parasysh vetëm të ardhurat e lidhura me shitjen e shërbimeve me pakicë celulare. Këto të ardhura do të përcaktohen duke iu referuar çmimit të aplikuar në shitjen e veçantë të secilit element përbërës të paketës, nëse është i mundshëm, ose shitjes së shërbimeve të tilla me të njëjtat karakteristika në mënyrë të pavarur (*stand-alone*).
4. Në mënyrë që të përcaktohet pjesa e të ardhurave të përgjithshme me pakicë të shërbimeve celulare të lidhura me ofrimin e shërbimeve të rregulluara me pakicë të roaming-ut, do të zbatohet metodologjia e përcaktuar në Aneksin II, pikat (1) dhe (5).

Neni 10

Vlerësimi i aplikimeve për autorizim për të zbatuar një tarifë shtesë roaming

1. Kur vlerëson një kërkesë për autorizim për të zbatuar një tarifë shtesë roaming të paraqitur nga një operator celular, në përputhje me pikën 4/7 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e modelit të tij të tarifimit të brendshëm, AKEP-i mund të arrijë në përfundimin se aplikuesi nuk është në gjendje të rikuperojë kostot e tij për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roaming-ut, që dëmton qëndrueshmërinë e modelit të tij të tarifimit për shërbimet brenda vendit, vetëm kur vlera absolute e marzhit neto negativ të shitjes me pakicë të roaming-ut të aplikuesit është e barabartë ose më e madhe se 3% e vlerës së marzhit të tij të shërbimeve celulare.
Marzhi neto i shitjes me pakicë të roaming-ut do të jetë shuma e mbetur, pasi kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut zbriten nga të ardhurat nga ofrimi i këtyre shërbimeve, siç përcaktohet në përputhje me këtë Rregullore. Për të përcaktuar këtë, AKEP-i do të shqyrtojë të dhënat e paraqitura në aplikim për të siguruar pajtueshmërinë me metodologjinë për përcaktimin e kostove dhe të ardhurave, siç përcaktohet në nenet 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje.
2. Megjithatë, kur vlera absolute e marzhit neto të shitjes me pakicë të roaming-ut është e barabartë ose më e madhe se 3% e vlerës së marzhit të shërbimeve celulare, dhe AKEP-i mund të vërtetojë se qëndrueshmëria e modelit të tarifimit brenda vendit të aplikuesit nuk ka mundësi të dëmtohet për shkak të rrethanave specifike, kërkesa do të refuzohet nga AKEP. Rrethana të tilla përfshijnë situata në të cilat:
 - (a) aplikuesi është pjesë e një grupi dhe ka prova të transferimit të brendshëm të çmimit (*internal transfer pricing*) në favor të filialeve të tjerë të grupit brenda BP-së, veçanërisht në funksion të disbalancave të konsiderueshme të tarifave të shitjes me shumicë të zbatuara brenda grupit;
 - (b) shkalla e konkurrencës në tregun brenda vendit do të thotë se ka kapacitet për të përballuar marzhet e reduktuara;

(c) zbatimi i një politike më kufizuese të përdorimit të drejtë, përsëri në përputhje me nenet 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje, do të reduktonte marzhin neto të shitjes me pakicë të roaming-ut në një proporcion prej më pak se 3%.

3. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur një operator ka një marzh negativ të shërbimeve celulare dhe një marzh neto negativ të shitjes me pakicë të roaming-ut, AKEP-i do të autorizojë aplikimin e një tarife shtesë për shërbimet e rregulluara të roaming-ut.
4. Kur autorizohet zbatimi i taifës shtesë për shërbimet e rregulluara të roaming-ut, vendimi përfundimtar i AKEP-it do të identifikojë shumën e konstatuar të marzhit negativ të shitjes me pakicë të roaming-ut, që mund të rikuperohet përmes aplikimit të një tarife shtesë me pakicë në shërbimet e roaming-ut të ofruara brenda BP-së. Tarifa shtesë do të jetë në përputhje me supozimet e trafikut roaming që mbështet vlerësimin e aplikimit dhe do të vendoset në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 9918/2008.

KAPITULLI IV PËRCAKTIME FINALE

Neni 11

Monitorimi i politikave të përdorimit të drejtë dhe aplikimeve për autorizim për zbatimin e tarifave shtesë për roaming-un

Për të garantuar zbatimin e qëndrueshëm të pikave 4/6-8 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP-it, dhe përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, AKEP-i ka të drejtë të kërkojë informacion nga operatorët celularë, ndër të tjera në lidhje me:

- Dokumentacionin e kërkuar nga operatorët për të përcaktuar rezidencën e klientit roaming;
- Çdo politë të drejtë përdorimi (FUP) që mund të zbatohet nga operatorët në përputhje me këtë rregullore;
- Çdo kërkesë për aplikim të tarifës shtesë për roaming, dhe;
- Efektet e aplikimit të FUP dhe tarifave shtesë për RLAH në BP.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën 1 Korrik 2021.

Aneks I

Ndryshimi proporcional në vëllimet aktuale të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut sipas RLAH, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar:

$$\left(\frac{\sum_1^n \text{volume}_k(t)}{\sum_1^n \text{volume}_k(t-1)} - 1 \right) \times 100$$

ku:

k = shërbimi (1 = thirrje zanore, 2 = SMS, 3 = të dhëna);

n - është numri i ditëve të aplikimit RLAH ($n \geq 30$); dhe

t - është viti i aplikimit të parë RLAH.

Kjo përqindje duhet të përdoret për të vlerësuar ndryshimin në vëllime gjatë periudhës së parashikuar 12 mujore, duke e shumëzuar atë me vëllimet në vitin e mëparshëm.

Aneks II

- (1) Peshat w_k të shërbimeve celulare me pakicë:

$$w_k = \frac{\text{çmimi mesatar me shumicë i roamingut i paguar nga operatori } k_i}{\sum_{k=1}^3 \text{çmimi mesatar me shumicë i roamingut i paguar nga operatori } k}$$

ku:

k = shërbimi (1 = thirrje zanore, 2 = SMS, 3 = të dhëna);

“Çmimi mesatar me shumicë i roamingut i paguar nga operatori” i referohet çmimit mesatar për njësi për trafikun e pabalancuar të paguar nga operatori për secilin shërbim, ku njësia për secilin shërbim është eurocent për (i) minuta për thirrjet zanore; (ii) SMS për SMS; dhe (iii) MB për të dhëna.

- (2) Raporti i vëllimit të përgjithshëm të trafikut të shërbimeve të roamingut me pakicë të aplikantit ndaj trafikut të përgjithshëm me pakicë roaming dalës (outbound) dhe trafiku me shumicë roaming hyrës (inbound) të shërbimeve të tij roaming:

$$\frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë}}{\text{trafiku roaming (dalës me pakicë + hyrës me shumicë)}} = \sum_{k=1}^3 w_k \times \frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë } k}{\text{trafiku roaming (dalës me pakicë + hyrës me shumicë)}k}$$

ku:

k = shërbimi (1 = thirrje zanore, 2 = SMS, 3 = të dhëna);

- (3) Raporti i vëllimit të përgjithshëm të trafikut të shërbimeve të roamingut me pakicë të aplikantit brenda BP ndaj trafikut të përgjithshëm të shërbimeve të tij të roamingut me pakicë brenda dhe jashtë BP:

$$\frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë brenda BP}}{\text{trafiku roaming dalës me pakicë (BP + joBP)}} = \sum_{k=1}^3 w_k \times \frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë brenda BP } k}{\text{trafiku roaming dalës me pakicë (BP + joBP)}k}$$

ku:

k = shërbimi (1 = thirrje zanore, 2 = SMS, 3 = të dhëna);

- (4) Raporti i trafikut të përgjithshëm të shërbimeve të roamingut me pakicë të aplikantit brenda BP ndaj trafikut të përgjithshëm me pakicë të të gjitha shërbimeve celulare me pakicë:

$$\frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë brenda BP}}{\text{trafiku roaming dalës me pakicë (BP + joBP) + trafiku me pakicë brenda vendit}} = \sum_{k=1}^3 w_k \mathbf{X} \frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë brenda BP } \mathbf{k}}{\text{trafiku roaming dalës me pakicë (BP + joBP)}\mathbf{k} + \text{trafiku me pakicë brenda vendit } \mathbf{k}}$$

ku:

\mathbf{k} = shërbimi (1 = thirrje zanore, 2 = SMS, 3 = të dhëna);

(5) Të ardhurat me pakicë të roamingut të BP-së:

Të ardhurat me pakicë nga roaming në BP = Të ardhurat me pakicë nga shërbimet celulare

$$\mathbf{x} \sum_{k=1}^3 w_k \mathbf{X} \frac{\text{trafiku roaming dalës me pakicë brenda BP } \mathbf{k}}{\text{trafiku roaming dalës me pakicë (BP + joBP)}\mathbf{k} + \text{trafiku me pakicë brenda vendit } \mathbf{k}}$$

ku:

\mathbf{k} = shërbimi (1 = thirrje zanore, 2 = SMS, 3 = të dhëna).